



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI “FAN S. NOLI”  
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË**

**SIMPOZIUM SHKENCOR ME TEMË:**

**SIGURIMI I CILËSISË SË BRENDSHME NË  
PROGRAMET UNIVERSITARE TË MËSIMDHËNIES  
SË GJUHËVE TË HUAJA**



## E premte, 5 qershor, 2015

<b>09:00-10:00</b>	<b>Regjistrimi (Holli i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë)</b>	
<b>10:00-10:30</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Fjala e hapjes së simpoziumit nga Prof. dr. Ali Jashari, dekan i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë</li><li>- Përshëndetje nga Prof.as. dr. Gjergji Mero, rektor i Universitetit “Fan S. Noli”</li><li>- Përshëndetje nga prof. Dhurata Bozo, drejtore e APAAL, Tiranë</li></ul>	
<b>10:30-11:45</b>	<b>Paraqitja e kumtesave</b> <b>Moderatorë: Prof. as. dr. Pavllo Cicko, dr. Benita Stavre, doc. Vasilika Pojani</b>	

**Sigurimi i Cilësisë së Brendshme**

<p><b>Dr. Benita Stavre</b> <b>Zv. Rektore</b> Universiteti “Fan S.Noli” Korçë</p>	<p><b>Kurrikula universitare - një urë lidhëse mes teorisë dhe praktikës në mësimdhënien e gjuhës së huaj</b></p>	
<p><b>Dr. Alda Cicko,</b> Departamenti i Gjuhëve të Huaja <b>Msc. Olger Brame,</b> Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë Universiteti “Fan S.Noli” Korçë</p>	<p><b>Mësimdhënia që synon rezultatet e të nxënit në arsimin e lartë</b></p>	<p><b>10:30-10:35</b></p>
<p><b>Msc. Alma Karasaliu</b> Departamenti i Gjuhëve të Huaja <b>Prof. as. dr. Pavllo Cicko</b> Departamenti i Gjuhëve të Huaja <b>Albina Pajo</b> Departamenti i Edukimit Universiteti “Fan S.Noli” Korçë</p>	<p><b>Vështrim përqasës mes lëndëve të formimit të përgjithshëm dhe atyre të drejtimeve të tjera</b></p>	<p><b>10:35-10:40</b></p>
<p><b>Dr. Belfjore Qose</b></p>	<p><b>Disa probleme të sigurimit të cilësisë në mësimdhënien e</b></p>	<p><b>10:40-</b></p>

**Sigurimi i Cilësisë së Brendshme**

	Ministria e Arsimit dhe Sportit	<b>letërsisë shqipe në gjuhën angleze në Arsimin e Lartë</b>	<b>10:45</b>
	<b>Dalina Jashari</b> Doktorante pranë Institutit të Studimeve Europiane	<b>Procesi i diversifikimit si shprehje e cilësisë në Arsimin e Lartë</b>	<b>10:50-10:55</b>
	<b>Dr. Daniela Carmen Stoica</b> Departamenti i Gjuhëve të Huaja Universiteti “Fan S.Noli” Korçë	<b>Gjendja aktuale e Arsimit të Lartë në Shqipëri: ndryshimet dhe pasqyrimi i tyre në sistem.</b>	<b>10:55-11:00</b>
	<b>Msc. Dorela Kaçauni</b> Departamenti i Gjuhëve të Huaja <b>Msc. Lorena Robo</b> Departamenti i Gjuhëve të Huaja <b>Dr. Edlira Xega</b> Departamenti i Gjuhëve të Huaja Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë	<b>Sigurimi i cilësisë së mësimdhënies përmes përdorimit të TIK në përvetësimin e tregimeve në gjuhën angleze</b>	<b>11:00-11:05</b>
	<b>Prof. as. dr. Elida Tabaku</b> Përgjegjëse e Departamentit të Gjuhës Angleze, FGJH, UT	<b>Kurrikula: një lehtësi apo pengesë për lëvizjen e studentëve?</b>	<b>11:05-11:10</b>

**Sigurimi i Cilësisë së Brendshme**

	<p><b>Prof. as. dr. Rregjina Gokaj</b> Zv. Rektore, UAMD</p>		
	<p><b>Prof. as. dr. Ema Kristo</b> Universiteti i Elbasanit Fakulteti i Shkencave Humane Universiteti i Mynihut Katedra e Albanologjisë</p>	<p><b>Studimet dydisplimore – një përvojë e re për arsimin shqiptar</b></p>	<p><b>11:10-11:15</b></p>
	<p><b>Dr. Erinda Papa</b> Departamenti i Gjuhëve të Huaja</p> <p><b>Doc. Robert Stratobërdha</b> Departamenti i Gjuhëve të Huaja Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë</p>	<p><b>Përfshirja e studentëve në procesin arsimor: sfida dhe rekomandime</b></p>	<p><b>11:15-11:20</b></p>
	<p><b>Dr. Eriola Qafzezi</b> Departamenti i Gjuhëve të Huaja Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë</p>	<p><b>Analiza e gabimeve gjatë përkthimit nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe anasjelltas</b></p>	<p><b>11:20-11:25</b></p>
	<p><b>Dr. Fabiola Kadi</b> Departamenti i Gjuhëve të Huaja</p>	<p><b>Roli i objektivave dhe ndikimi i tyre në përmirësimin e cilësisë</b></p>	<p><b>11:25-11:30</b></p>

**Sigurimi i Cilësisë së Brendshme**

	Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë	së mësimdhënies	
<b>Dr. Gladiola Sadiku/ Dr. Gentian Sadiku</b>	Universiteti “A. Xhuvani”  Fakulteti i Shkencave Humane  Departamenti i Gjuhëve Angleze dhe Gjermane	Programet e studimit dydisiplinore – një mundësi drejt përafrimit të kurrikulave të sistemit arsimor universitar shqiptar me atë evropian	11:30-11:35
<b>Msc. Juliana Çyfeku</b>	Departamenti i Gjuhëve të Huaja <b>Dr. Lindita Kaçani</b>  Departamenti i Gjuhëve të Huaja Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë	Përdorimi i teknologjisë kompjuterike në mësimnxënien e gjuhës angleze në Arsimin e Lartë	11:35-11:40
<b>Doc. Vasilika Pojani</b>	Departamenti i Gjuhëve të Huaja <b>Msc. Suela Koça</b>	Vlerësimi i vazhduar dhe ndikimi i tij në cilësinë e procesit mësimor	11:40-11:45

Departamenti i  
Gjuhëve të Huaja  
Universiteti “Fan S.  
Noli”, Korçë

**KURRIKULA UNIVERSITARE -  
NJË URË LIDHËSE MES TEORISË DHE  
PRAKTIKËS NË MËSIMDHËNIEN E GJUHËS SË  
HUAJ**

**Dr. Benita Stavre**  
**Zv. Rektor Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë**  
**[b.stavre@gmail.com](mailto:b.stavre@gmail.com)**

Arsimi i lartë shqiptar ka filluar prej vitesh përpjekjet konkrete për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si detyrim legjitim që ai ka ndaj të qenit një institucion në shërbim të komunitetit. Standardet kombëtare të sigurimit të cilësisë kanë krijuar kornizën brenda së cilës secili institucion apo njësi përbërëse ndërmerr nisma në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulave, të kërkimit shkencor, të kualifikimit të stafit akademik dhe të infrastrukturës. Në rastin e programeve të mësimdhënies së gjuhëve të huaja ky zinxhir aktiviteteve duhet realizuar në mënyrë të tillë që të ndërthurë edhe disa aspekte të rëndësishme të kompetencës gjuhësore, të përfaqes së fenomenit sociolinguistik, të aftësisë së mësimdhënies si dhe të kuptuarin e veçorive të të nxënit. Punimi synon të analizojë nivelin deri në të cilin kurrikula universitare e programit të Gjuhës Angleze në nivelit “Bachelor” dhe ajo e programit “Master Profesional” në Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Lartë në Gjuhë Angleze në Universitetin e Korçës i pajis studentët që do të diplomohen si mësues të gjuhës angleze në AML, me njohuritë që u nevojiten për të arritur standardet e kërkuara në mësimdhënien e kësaj gjuhe në nivelin parauniversitar. Për këtë shqyrtohen



planet mësimore të këtyre dy programeve, natyra e fondit të pyetjeve hartuar mbi Programin e Provimit të Shtetit për Mësuesit e Gjuhës Angleze dhe Standardet e Përgjithshme të Mësuesit të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vitin 2013. Duke u munduar t'i analizojë këto dokumentacione nën dritën e parimeve të Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët, punimi synon të sugjerojë aspekte që sigurojnë rritjen e cilësisë së kurrikulës universitare të mësimdhënies së gjuhëve të huaja me lëndë, module apo njohuri që ofrojnë një gamë mundësish për të ngushtuar hapësirën mes teorisë së formimit akademik dhe zbatimit të saj praktik në kontekstin aktual shqiptar.

**Fjalë kyçe:** *kurrikul universitare, mësimdhënës i gjuhëve të huaja, profesion i rregulluar, të nxëniet gjatë gjithë jetës, profil i përbashkët evropian*

## **MËSIMDHËNIA QË SYNON REZULTATET E TË NXËNIT NË ARSIMIN E LARTË**

**Dr. Alda Cicko**

Departamenti i Gjuhëve të Huaja  
Universiteti “Fan S.Noli” Korçë

**Msc. Olger Brame**

Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë  
Universiteti “Fan S.Noli” Korçë

Reforma e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, e cila ka filluar në Shqipëri që prej vitit 2014, e sheh arsimin e lartë si të mirë publike dhe shërbim publik. Një ndër qëllimet kryesore që ka përcaktuar kjo reformë lidhet me përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë, i cili, mes të tjerash, do të arrihet edhe nëpërmjet mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore, si një drejtim i rëndësishëm i kësaj reforme. Nga ana tjetër, një qëllim kyç i Standardeve dhe Udhëzimeve për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (ESG) mbetet ndihmesa në mirëkuptimin e përbashkët të sigurimit të cilësisë për mësimnxënien dhe mësimdhënien përtej kufijve dhe ndër të gjithë aktorët.

Vetë institucionet arsimore janë bërë më të larmishme në misionet e tyre, në mënyrën në të cilën ofrojnë arsimin dhe bashkëpunimin, duke përfshirë rritjen e ndërkombëtarizimit, mësimin digjital dhe forma të reja të shpërndarjes, duke siguruar cilësinë, e cila është thelbësore në garantimin e kualifikimeve të arritura nga studentët. Në këtë mënyrë, përvoja e tyre në arsimin e

lartë mbetet kryesore në misionet institucionale, duke orientuar drejt rezultateve të nxënies si pohime të asaj që studentët pritet të dinë, të kuptojnë dhe të demonstrojnë rezultate të cilat janë të shprehura dhe konkretizuara nëpërmjet kompetencave.

Në punimin tonë do të përpiqemi të sjellim në vëmendje pikërisht disa elemente që lidhen me këtë lloj mësimdhënieje, që përqendrohet te rezultatet e të nxënit dhe rolin e aktorëve kryesorë në këtë proces; të stafit mësimdhënës në fakultete dhe studentët.

**Fjalë kyçe:** *metoda mësimdhënieje, rezultatet e të nxënit, arsim i lartë, mësimdhënie, sigurim i cilësisë*

## VËSHTRIM PËRQASËS MES LËNDËVE TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM DHE ATYRE TË DREJTIMEVE TË TJERA

**Alma Karasaliu**  
Departamenti i Gjuhëve  
të Huaja  
Universiteti “Fan S.  
Noli”, Korçë

**Prof.as.dr. Pavllo  
Cicko**  
Departamenti i Gjuhëve  
të Huaja  
Universiteti “Fan S.  
Noli”, Korçë

**Albina Pajo**  
Departamenti i Edukimit  
Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

Në kuadër të reformave të ndërmarra në arsimin e lartë, vëmendje iu kushtua edhe objektivave formuese të programeve të studimit të ofruara nga universitetet, si edhe mundësive që ato u ofrojnë studentëve në fushën e punësimit, gjë që do të çojë, padyshim, në rritjen e cilësisë së programeve të ofruara. Po në këtë aspekt, prioritet iu dha edhe orientimit të programeve të studimit në një profil të vetëm, duke shmangur programet dy-profilëshe. Gjatë këtij punimi, do të përpiqemi të përjasim programet e studimit të ciklit të parë "Gjuhë - Letërsi Shqipe dhe Frënge", i cili është në fund të ekzistencës së tij dhe atij të propozuar për vitin e ri akademik 2015-2016, "Gjuhë dhe Kulturë Frënge", me qëllim të nxjerrim në pah ndryshimet e sugjeruara, arsyen/t që kanë çuar në zbatimin e tyre, si dhe risitë që u ofrohen studentëve të ardhshëm. E gjithë analiza përjasëse do të kryhet duke u bazuar në të dhënat e

nxjerra prej dy rregulloreve të programeve të studimit, të cilat do të paraqiten edhe grafikisht, me qëllim pasqyrimin më të qartë të ndryshimeve të vërejtura. Në përfundim, nisur nga sugjerimet lidhur me ristrukturimin e planit mësimor, do të theksohen ndryshimet në raportin mes disiplinave përkatëse, në të cilat 70% të hapësirës zënë ato të formimit të përgjithshëm (bazë) dhe 30% ato të profilit karakterizues, integrues, disiplinat me zgjedhje e të tjera si këto. Po në këtë kontekst, do të theksohen disavantazhet që paraqiste të ofruarit e programit të studimeve, me dy profile, përsa i përket punësimit, duke e shoqëruar me të dhëna rreth studentëve të diplomuar, të cilët kanë arritur të punësohen, si edhe të atyre që vazhdojnë ciklin e dytë të studimeve, për të dalë në përfundimin bazë, sipas të cilit, pajisja e studentëve me njohuri të thelluara është më frytdhënëse dhe më e përshtatshme, jo vetëm përsa i përket formimit të tyre, por edhe përsa i përket mundësisë së punësimit që, në ditët e sotme, u jep më tepër prioritet të diplomuarve në programe studime të karakterit njëprofilësh.

**Fjalë kyçe:** *formim i thelluar, disiplinë, program studimi dyprofilësh, disavantazhe, rritja e cilësisë*

# **DISA PROBLEME TË SIGURIMIT TË CILËSISË NË MËSIMDHËNIEN E LETËRSISË SHQIPE NË GJUHËN ANGLEZE NË ARSIMIN E LARTË**

**Dr. Belfjore Qose**

Ministria e Arsimit dhe Sportit

[belfjore@yahoo.com](mailto:belfjore@yahoo.com)

Sigurimi i cilësisë në sistemin shqiptar të Arsimit të Lartë është thelbësor për të garantuar performancë dhe qëndrueshmëri në procesin e mësimdhënies, si dhe një produkt njerëzor që përballet me tregun e punës. Korniza e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë në Shqipëri mund të konsiderohet pjesërisht e zhvilluar dhe ne besojmë se përballemi me disa probleme kyç në sfondin teorik dhe, gjithashtu, praktikisht në sigurimin e mësimdhënies cilësore. Megjithatë, ne kemi pritshëri të larta për të ardhmen e zhvillimit dhe përmirësimit e arsimit shqiptar, në rruajtjen e një kufiri konkurrues brenda njohurive globale: kjo është arsyeja pse në këtë punim ne po përqëndrohemi në disa probleme të mësimdhënies së Letërsisë Shqipe në gjuhën angleze.

Mësimdhënia e gjuhës shqipe në anglisht është e një rëndësie të veçantë, sepse ndihmon në rritjen e njohjes dhe përfaqësimit të letërsisë sonë që kohët e fundit praktikohet në disa universitete private, ku mësimdhënia ofrohet në gjuhën angleze.

Mësimdhënia cilësore, së pari, duhet të mbështetet nga një tekst shkollor i përkthyer i Letërsisë shqipe, por një projekt i tillë kërkon kohë dhe burime njerëzore me njohuri dhe aftësi të larta akademike. Përkthimi i termave mund të bëjë që të humbasë, të transformohet

ose të ndryshojë kuptimin fillestar, për shkak të konteksteve dhe kuptimeve të tyre të ndryshme.

Metodologjia e përdorur në këtë kërkim do të jetë e orientuar drejt cilësisë në vetvete, nëpërmjet së cilës problemet e shtruara *do të analizohen* me qëllim gjetjen e “një kure”. Theksi që vendosëm te cilësia sugjeron përdorimin e *vlerësimit* si një mënyrë për të matur feedback-un për mësimdhënie më të mirë. Kjo është arsyeja pse ndonjëherë do t’u referohemi rezultateve të studentëve, ndërkohë që zbatojmë metoda të ndryshme të mësimdhënies së Letërsisë Shqipe. Termave të përdorura dhe disa fenomeneve specifike të Letërsisë Shqipe do t’u jepen vlera *interpretuese*.

**Fjalë kyçe:** *sigurimi i cilësisë, transformim, terminologji, përmirësim*

# **PROCESI I DIVERSIFIKIMIT SI SHPREHJE E CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

**Dalina Jashari**

Doktorante pranë Institutit të Studimeve Evropiane  
Tiranë

Diversifikimi në arsimin e lartë është procesi në të cilin sistemi bëhet më i shumëllojshëm ose i ndryshëm në orientim dhe në funksionim. Diversifikimi shpesh shpang sistemin uniform dhe të ngurtë të arsimit të lartë drejt një sistemi të ndryshëm dhe të ndryshueshëm.

Diversifikimi shihet në ndryshueshmërinë dhe shumëlloshmërinë e institucioneve të arsimit dhe të programeve të studimit që ofrojnë ato. Disa autorë e analizojnë diversitetin e arsimit të lartë në disa aspekte: diversiteti strukturor i pasqyruar te strukturat organizative të institucioneve të arsimit të lartë; diversiteti i programeve të studimit, i cili shfaqet te kurrikula mësimore; diversiteti procedural, i cili konkretizohet te modelet e të mësuarit etj.

Diversiteti ekziston brenda dhe ndërmjet institucioneve. Në ditët tona, diskursi mbi diversitetin ndërmjet institucioneve ka të bëjë me misionin, studentët, madhësinë, menaxhimin dhe kontrollin. Ndërkohë që diversiteti brenda institucionit lidhet me praktikat e kërkimit, kurrikulat dhe programet e studimit, si dhe cilësinë e programit të studimit. (Teichler, 2008). Procesi i diversifikimit sjell dhe diferencimin institucional (Neave, 2000). “Diferencimi” nënkupton ndarjen e njërive kryesore ekzistuese dhe nevojën për



hapjen e njësive të reja brenda sistemit ekzistues arsimor.

Diversifikimi, gjithashtu, vërehet dhe në organizimin e njësive bazë dhe grupeve mësimore-kërkimore apo dhe në programet e studimit, brenda sistemit kombëtar të arsimit të lartë të vendit.

Procesi i diversifikimit, në analizë të fundit, shihet si shprehje e njëmendtë e cilësisë në arsimin e lartë dhe qëndron përkundër homogjenizimit.

**Fjalë kyçe:** *arsimi i lartë, diversifikim, diversitet, homogjenizim*

# **GJENDJA AKTUALE E ARSIMIT TË LARTË NË SHQIPËRI: NDRYSHIMET DHE PASQYRIMI I TYRE NË SISTEM**

**Dr. Daniela Carmen Stoica**  
Departamenti i Gjuhëve të Huaja  
Universiteti “Fan S. Noli”

Ky punim është rezultat i një analize krahasuese të disa aspekteve të sistemeve të Arsimit të Lartë në Shqipëri dhe SHBA, i mundur nga përvoja e përfutur gjatë programit JFD, pjesë e të cilit ishte edhe autorja në Universitetin e Berkeley- t në vitin 2009. Së pari, punimi trajton disa nga sfidat më të rëndësishme me të cilat Arsimi i Lartë shqiptar është përballur ndër vite, si dhe me ato çka përballlet sot, veçanërisht në lidhje me cilësinë në kushtet e zbatimit të Deklaratës së Bolonjës. Besueshmëria, në këtë rast, e lidhur drejtpërdrejt me procesin e akreditimit, në të cilin janë përqendruar tani institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri, është një proces që me besim do të çojë në ndryshime pozitive, decentralizim dhe vetërregullim të sistemit të lartë arsimor. Më tej, punimi analizon faktorët kryesorë të cilët ushtrojnë ndikim në ndryshimin e sistemit të Arsimit të Lartë, si p.sh., faktori i globalizimit, roli që luajnë agjencitë e akreditimit në mbikëqyrjen e ndryshimit, si dhe përdorimi i teknologjisë në procesin mësimor. Së fundi, procesi i akreditimit është parë si faktori kryesor i ndryshimit në lidhje me cilësinë dhe besueshmërinë.

**Fjalë kyçe:** *Arsimi i Lartë, cilësi, besueshmëri*

**SIGURIMI I CILËSISË SË MËSIMDHËNIES  
PËRMES PËRDORIMIT TË TEKNOLOGJISË SË  
INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT NË  
PËRVETËSIMIN E TREGIMEVE NË GJUHËN  
ANGLEZE**

**Msc. DORELA  
KAÇAUNI**

Departamenti i Gjuhëve  
të Huaja  
Universiteti “Fan S.  
Noli”, Korçë

**Msc. LORENA  
ROBO**

Departamenti i Gjuhëve  
të Huaja  
Universiteti “Fan S.  
Noli”, Korçë

**Dr. EDLIRA XEGA**

Departamenti i Gjuhëve të Huaja  
Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

Mësimdhënia dhe mësimnxënia e gjuhëve të huaja përmes Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) është një prirje e re në të gjithë botën. Teknologjia po luan një rol të madh gjatë studimeve në auditor, por edhe në shtëpi.

Lidhur me përdorimin e gjerë dhe të ndryshimeve teknologjike kjo kumtesë shqyrton qëndrimet dhe mendimet e studentëve për integrimin e TIK në mësimin e gjuhës angleze dhe si ndikon TIK në sigurimin e cilësisë së mësimdhënies në arsimin e lartë.

Pjesëmarrësit e këtij studimi janë 21 studentë të degës së Gjuhës Angleze në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë në Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë. Atyre iu kërkua të

realizonin një projekt bazuar në rubrikën “Writing Folder 3: Stories 1” në modulën e “Analizës së Tekstit 1”. Studentët duhet të paraqitnin një montazh për një tregim, duke e ilustruar me figura dhe me zërin e tyre.

Më pas, studentët plotësuan një pyetësor që përmbante pyetje mbi mendimet e tyre për përdorimin e TIK në mësimin e gjuhës angleze, në lidhje me projektin që realizuan etj.

Përfundimet na dhanë informacion të rëndësishëm dhe sugjerime për përshtatjen e TIK në mësimin e gjuhës së huaj. Gjithashtu, përmes projektit studentët përmirësuan jo vetëm aftësitë e tyre gjuhësore, por edhe aftësitë e tyre kompjuterike.

**Fjalët kyçe:** *mendimet e studentëve, projekt, montazh, aftësi kompjuterike, aftësi gjuhësore*

## **KURRIKULA: NJË LEHTËSI APO PENGESË PËR LËVIZJEN E STUDENTËVE?**

**Prof. as. dr. Elida Tabaku**

Përgjegjëse e Departamentit të Gjuhës Angleze, FGJH  
UT

**Prof. as. dr. Rregjina Gokaj**

Zv. Rektore, UAMD

Në këtë simpozium, lidhur me një çështje mjaft delikate dhe aktuale si ajo e sigurimit të cilësisë së brendshme, kemi menduar të trajtojmë një nga elementet kyçe dhe zanafillën për të arritur më pas në synimin tonë të përbashkët për sigurimin e cilësisë. Kurrikula e programeve të studimit në universitetet tona është një problem që akoma haset dhe nuk po gjen një rrugëdalje përfundimtare. Që nga miratimi i Kartës së Bolonjës, edhe pas kaq viteve të zbatimit të saj në të gjitha universitetet shqiptare, problematet që sjell kurrikula për studentët tanë mbeten në rend të ditës. Në këtë simpozium kemi menduar të shtrojmë disa pyetje, për të cilat mund të dalim në përgjigje konkrete dhe të ofrojmë zgjidhje të frytshme dhe afatgjata të këtyre çështjeve për studentët tanë, te të cilët ne kemi përgjegjësinë të projektojmë të ardhmen. Ato janë:

Kurrikula është guri i themelit për një program studimi. Si ndërtohet ajo?

Kurrikula është “fytyra” e një programi studimi. Si konceptohet ajo?

Kurrikula është thelbi i njohurive që duhet të merren nga një program studimi. Sa e dëmton apo e ndihmon konformizmi sipas udhëzimeve në fuqi?

Kurrikula është viza e një studenti. A duhet të mbajë ajo peshën e “kartabiankës”?

Cilat janë pengesat dhe lehtësitë e kurrikulave të ngjashme?

Cilat janë rrugët drejt përmirësimit të kurrikulave në të mirë të programeve sa më cilësore?

A duhet të shkojmë drejt kurrikulave të njësuara për programe të njëjta studimi në universitetet tona?

**Fjalët kyçe:** *kurrikula, programe studimi, kredite, module, lëvizja e studentëve, unifikimi etj.*

## **STUDIMET DYDISPLINORE – NJË PËRVOJË E RE PËR ARSIMIN SHQIPTAR**

**Prof. as. dr. Ema Kristo**  
Universiteti i Elbasanit  
Fakulteti i Shkencave Humane  
Universiteti i Mynihut  
Katedra e Albanologjisë

Bota po bëhet gjithmonë e më e vogël dhe globalizmi nuk mund të ndalet më. Komunikimi midis shtatë kontinenteve është bërë diçka krejt normale dhe e përditshme. Nëse hedhim një vështrim disa vite më parë, gjithçka kishte ritëm shumë herë më të ngadaltë se ky i sotmi.

Zbulimet shkencore dhe teknologjia janë bërë pjesë të së sotmes. Jeta, ekonomia dhe shoqëria po bëhen gjithmonë e më komplekse. Dijet e fituara vjetrohen shumë shpejt dhe kërkesat profesionale të punëmarrësve rriten si në aspektin teorik, ashtu edhe në atë teknik, social, organizativ apo emocional.

Edhe shoqëria e sotme shqiptare, sikurse edhe ajo globale, po përballet me ndryshime të shumta ekonomike dhe sociale, të cilat vinë bashkë me probleme të ndryshme.

Për këtë, një reformim i programeve të studimit në Shqipëri është i domosdoshëm. Ajo ndihmon, mbi të gjitha, për t'i bërë shkollat e larta të afta dhe të qëndrueshme për të ardhmen dhe u ofron studentëve kushtet më të mira paraprake për t'u pritur mirë në tregun evropian të punës.

Në këtë kuadër, mjaft interesante për arsimin shqiptar po bëhen studimet dydisiplinore, të konsoliduara tashmë prej vitesh në universitetet europiane. Ato kombinojnë dy lëndë të fushave të ndryshme dhe u ofrojnë studentëve shansin dhe mundësinë e një formimi më të gjerë dhe aftësinë për të aplikuar metoda shkencore më të avancuara. Studentët pajisen në këtë mënyrë me kompetenca bazë të domosdoshme për të ushtruar profesione të ndryshme, krahas atij të mësuesisë, në përputhje me kërkesat e një tregu gjithmonë e në ndryshim. Në ditët e sotme edukimi dhe zhvillimi i studentëve me kompetenca kyç është një nga çështjet më të diskutuara në sistemin arsimor shqiptar e më gjerë. Ky sistem arsimimi orientohet drejt kombinimit të dijeve, aftësive dhe qëndrimeve, si kompetenca që nevojiten për shpalosjen dhe zhvillimin personal, për përfshirje sociale, për të qenë qytetar aktiv etj.

Qëllimi i këtij punimi është paraqitja e rasteve konkrete të studimeve dydisiplinore në Universitetin e Elbasanit, duke pasqyruar përvojën e zbatimit të tyre, si dhe do të jepen disa propozime modeste në lidhje me zhvillimin e programeve të mëtejshme dydisiplinore, duke nënvizuar përparësitë e veçanta të këtyre studimeve, në këndvështrimin europian.



# **PËRFSHIRJA E STUDENTËVE NË PROCESIN ARSIMOR: SFIDA DHE REKOMANDIME**

**Dr. Erinda Papa      Doc. Robert Stratobërdha**

Departamenti i Gjuhëve të Huaja  
Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

Të nxënësit dhe zhvillimi i studentëve qëndron në themel të punës akademike, por, megjithatë, sot gjendja në universitetet shqiptare dëshmon për një mungesë të theksuar të të dhënave mbi përfshirjen e studentëve në praktika të suksesshme arsimore. Nëpërmjet një metode analitike ne synojmë të tregojmë shkallën e përfshirjes së studentëve në jetën akademike brenda dhe jashtë auditorëve, duke shfrytëzuar pyetësorin e NSSE (National Survey of Student Engagement), që zbatohet në pjesën më të madhe të universiteteve amerikane. Ky instrument u shfrytëzua për të nxjerrë të dhëna nga 110 studentë të programit të studimit “Gjuhë Angleze” Bachelor. Të dhënat e grumbulluara matnin përfshirjen e studentëve në fusha të tilla, si: procesi mësimor, marrëdhëniet me stafin mësimdhënës, këshillimi me zyrën e karrierës, objektivat e të nxënësit dhe përmbushja e tyre etj. Synimi i kësaj analize është të theksohet roli që luan përfshirja e studentëve në nxitjen e rritjes dhe menaxhimit të cilësisë në Arsimin e Lartë.

**Fjalë kyçe:** *përfshirja e studentëve, veprimtari mësimore, objektiva të të nxënësit, stafi akademik*

# **ANALIZA E GABIMEVE GJATË PËRKTHIMIT NGA GJUHA ANGLEZE NË GJUHËN SHQIPE DHE ANASJELLTAS**

**Dr. Eriola Qafzezi**

Departamenti i Gjuhëve të Huaja  
Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë cilësinë e përkthimit, duke u bazuar në një analizë të shembujve konkretë të teksteve të përkthyer nga studentët shqiptarë të kursit të tretë që studiojnë në programin e gjuhës angleze pranë Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë në Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë. Përkthimi zhvillohet si lëndë semestrale brenda programit të studimit të Gjuhës Angleze, kursi III. Kjo lëndë ka në thelb kombinimin e njohurive teorike dhe praktike në një lidhje të ndërsjelltë mes tyre. Studentët përfshihen në përkthime të teksteve autentike të shkruara në anglisht ose në shqip. Këto tekste përzgjidhen duke synuar shpalosjen e një sërë karakteristikave, të cilat dalin edhe më në pah nëpërmjet procesit të përkthimit. Ky punim synon të pasqyrojë dhe analizojë llojin e gabimeve që bëjnë studentët, duke shpresuar që një analizë e tillë të na ndihmojë për të kuptuar më thellë problemet që dalin gjatë përkthimit nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe anasjelltas. Një gjë e tillë do të na çojë drejt një cilësie më të lartë të përkthimit në vetvete për tekstet e marra në shqyrtim, por, parë në një këndvështrim më të gjerë e më praktik, do të na ndihmojë edhe në sigurimin e një cilësie më të lartë për mësimdhënien e gjuhës së huaj në arsimin e lartë.

**Fjalë kyçe:** *përkthim, cilësi, gabime, probleme, analiza.*

# **ROLI I OBJEKTIVAVE DHE NDIKIMI I TYRE NË PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË MËSIMDHËNIES**

**Dr. Fabiola Kadi**

Departamenti i Gjuhëve të Huaja,  
Universiteti F. S. Noli, Korçë

Në procesin e mësimdhënies, të të nxënit dhe në vlerësimin e studentëve, pedagogu është i interesuar të arrijë rezultate sa më të mira, të matshme në punën e tij. Për ta arritur këtë synim, shpesh përqendrohem te materialet mësimore, te procedurat e mësimdhënies, por është shumë e rëndësishme të vendosim në mënyrë sa më të qartë se çfarë presim që studentët tanë të përvetësojnë në fund të një ore mësimore ose në përfundim të një lënde apo moduli. Një element shumë i rëndësishëm për rezultate sa më të kënaqshme janë objektivat. Nëse objektivat mësimore hartohen në mënyrë sa më korrekte, ato u shërbejnë disa qëllimeve njëherësh: tërheqin vëmendjen e studentëve, kthehen në një formë udhëzimi në procesin e të nxënit, sigurojnë të dhëna për vlerësimin e studentëve si gjatë vitit, ashtu edhe për vlerësimin përfundimtar. Njohja e studentëve me objektivat në procesin e mësimin, i orienton ata dhe i motivon për të punuar në një drejtim të caktuar, duke mos humbur kohë thjesht në riprodhim të materialit të vënë në dispozicion. Objektivat përcaktojnë se çfarë duhet të dinë studentët dhe çfarë duhet të jenë të aftë të bëjnë, duke u kthyer kështu në një bazë të rëndësishme për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies, si edhe

komunikimin mes pedagogut dhe studentëve të tij, por edhe mes pedadogëve të të njëjtit program. Përcaktimi i objektivave lëndorë është një etalon matës për koherencën e një programi studimi, duke bërë të mundur verifikimin e rendit progresiv dhe shmangien e përsëritjeve apo boshllëqeve në mësimnxënien e synuar. Që të arrihet kjo, duhet bërë një punë e vërtetë ekipi me qëllim që programi të mos jetë thjesht një ‘vendosje’ lëndësh, por më tepër një ‘ansambël i organizuar’ që synon zhvillimin e integruar dhe optimal të aftësive.

**Fjalë kyçe:** *objektiva, përmirësim, komunikim, rezultate, të nxëniet.*

**PROGRAMET E STUDIMIT DYDISPLINORE –  
NJË MUNDËSI DREJT PËRAFRIMIT TË  
KURRIKULAVE TË SISTEMIT ARSIMOR  
UNIVERSITAR SHQIPTAR ME ATË EVROPIAN**

**Dr. Gladiola Sadiku/ Dr. Gentian Sadiku**  
Universiteti “A. Xhuvani”  
Fakulteti i Shkencave Humane  
Departamenti i Gjuhëve Angleze dhe Gjermane

Shoqëria e sotme shqiptare, sikurse edhe ajo globale, po përballlet me ndryshime të shumta ekonomike dhe sociale, të cilat vijnë bashkë me probleme të ndryshme. Një reformë e programeve të studimit në Shqipëri është e domosdoshme. Ajo duhet të ndihmojë, mbi të gjitha, për t'i bërë shkollat e larta të afta dhe të qëndrueshme për të ardhmen dhe t'u ofrojë studentëve kushtet më të mira paraprake për t'u pritur mirë në tregun evropian të punës. Hartimi i programeve dydisiplinore janë një hap drejt një reforme arsimore, që do të synonte përafrimin e sistemeve universitare me shumë vende të Evropës. Studimet dydisiplinore kombinojnë dy lëndë të fushave të ndryshme dhe u ofrojnë studentëve mundësinë e një formimi më të gjerë dhe aftësinë për të aplikuar metoda shkencore më të përparuara. Studentët pajisen, në këtë mënyrë, me kompetenca bazë të domosdoshme për të ushtruar profesione të ndryshme, krahas atij të mësuesisë, në përputhje me kërkesat e një tregu gjithmonë e në ndryshim. Qëllimi i këtij punimi është paraqitja e një rasti konkret të një studimi dydisiplinor në Universitetin e Elbasanit. Do të pasqyrohet përvoja e

zbatimit të këtij programi si dhe do të jepen disa propozime modeste në lidhje me zhvillimin e programeve të mëtejshme dydisiplinore, duke nënvizuar përparësitë e veçanta të këtyre studimeve, parë edhe në këndvështrimin evropian.

# **PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË KOMPJUTERIKE NË MËSIMNXËNIEN E GJUHËS ANGLEZE NË ARSIMIN E LARTË**

**Msc. Juliana Çyfeku**  
Departamenti i Gjuhëve  
të Huaja,  
Universiteti F. S. Noli,  
Korçë

**Dr. Lindita Kaçani**  
Departamenti i Gjuhëve  
të Huaja,  
Universiteti F. S. Noli,  
Korçë

Ky studim fokusohet në përdorimin e kompjuterit në mësimnxënien e gjuhës angleze si gjuhë e huaj në Arsimin e Lartë. Duke pasur parasysh interesin e madh në përdorimin e teknologjisë për mësimin sa më efikas të gjuhës angleze, është e rëndësishme të vëzhgohet se si teknologjia mund të zbatohet në këtë fushë studimi. Përmes këtij studimi synohet:

- 1) të kuptohet se si kompjuterat mbështesin veçanërisht mësimin e gjuhës në fjalë si gjuhë e huaj,
- 2) të shqyrtojë çdo evidence kërkimore-shkencore që përforcon mësimin e gjuhës,
- 3) të bindë të gjithë mësuesit e gjuhës angleze se teknologjia kompjuterike mund të rrisë gjerësisht përvetësimin e aftësive gjuhësore.

Çështjet që ky studim trajton nxjerrin në pah potencialet e teknologjisë kompjuterike dhe përdorimit të saj në fusha specifike. Ajo vë në dukje programet e mjetet përkatëse në aftësimin gjuhësor dhe në mësimin e testimin e gjuhës angleze me anë të kompjuterit. Për më tepër, ky studim sjell të dhëna të besueshme të nxjerra



nga kërkime shkencore që kanë përdorur metodologji sasiore dhe/ose cilësore.

Bazuar nga sa thamë më lart, kërkohet gërshetimi teorik i rëndësisë së përdorimit të teknologjisë kompjuterike me atë praktike në laboratorët e mësimit të gjuhës angleze në mënyrë autentike dhe efikase, duke mos ngelur në kornizën e ngurtë të dijeve për përdorim vetjak të kompjuterit nga mësuesit e studentët e arsimit të lartë. Gjithashtu, punimi shtron si nevojë diskutimin e çështjeve të rëndësishme metodologjike për studime të mëtejshme. Nga ky studim ne synojmë të nxjerrim përfundimin se përdorimi i teknologjisë kompjuterike në mësimdhënien e gjuhës së huaj në programin e studimit “Gjuhë angleze”, do të sjellë rezultate pozitive në rritjen e cilësisë së procesit të mësimdhënies si një nga indikatorët e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë.

**Fjalë kyçe:** *mësimi i gjuhës angleze si gjuhë e huaj, teknologji kompjuterike, lehtësim i mësimit të gjuhës, përvetësim , Arsimi i Lartë*

# VLERËSIMI I VAZHDUAR DHE NDIKIMI I TIJ NË CILËSINË E PROCESIT MËSIMOR

**Doc. Vasilika Pojani**

**Msc. Suela Koça**

Departamenti i Gjuhëve të Huaja  
Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

Nëpërmjet këtij punimi synojmë të analizojmë rolin e vlerësimit në përgjithësi dhe vlerësimit të vazhduar në veçanti, në kurrikul për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, për të përmirësuar performancën e studentëve dhe për të matur arritjet e tyre. Jemi përpjekur të jetësojmë metodat e vlerësimit të vazhduar të përdorura në të gjitha syllabuset e programit të studimit “Bachelor” Gjuhë angleze për vitin akademik 2014-2015 për të parë sa të larmishme janë ato dhe sa mundësojnë vlerësimin objektiv të studentëve gjatë zhvillimit të kursit. (lëndës) Bazuar në literaturën bashkëkohore dhe praktikën konkrete të vlerësimit të vazhduar në syllabuset e degës së gjuhës angleze, synojmë të ofrojmë modele vlerësimi dhe sugjerime që do t’i shërbenin përmirësimit të punës së pedagogëve, studentëve dhe vlerësimit të njohurive të dhëna dhe të marra. Njohja e metodave bashkëkohore të vlerësimit të vazhduar do të na ndihmonte të hartonim teknika të mirëmenduara mbi vlerësimin dhe të reflektonim konkretisht mbi praktikën tonë të vlerësimit.

**Fjalë kyçe:** *vlerësimi i vazhduar, arsimit i lartë, sigurimi i cilësisë, mësimdhënia, të nxënit, metodat e vlerësimit*